

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Ngërçi me pagat e magjistratëve/ Shoqata Evropiane e Gjyqtarëve: Të respektohet vendimi i Kushtetueses
ADRESA	https://www.cna.al/aktualitet/ngerci-me-pagat-e-magjistrateve-shoqata-evropiane-e-gjyqta-reve-te-res-i474477
BURIMI	cna.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 16:04:37 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 15:48:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	5bb0912ff917abd2d234e7c2041cdd388a1822ec38b9b5e14b3b4149a1bad817
TEKSTI	0234e06f224b184ec87620ea939545a2fb41691fac5511671cd8220ca95ed9a3
PAMJA	f3eeee9f85f4380b4b57b9a329da9894c4a6103104cb1ad7c437f6644321c4e0

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	a18e50f08ad1596ab1d97e0ddd18b3cf4f68d1e50dbc489e5ccc5112ba40edaf
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	565d15129a3a8f2c33135848c08d2b7db1d78c2d7a3d3b93f84b73cbde96b20f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/a18e50f08ad1596ab1d97e0ddd18b3cf4f68d1e50dbc489e5ccc5112ba40edaf

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)



English
English

E fundit!

x

18:01 Aktualitet

Nënkryetari i PD-së Belind Këlliçi gjatë fjalës së tij në ...

Ngërçi me pagat e magjistratëve/ Shoqata Evropiane e Gjyqtarëve: Të respektohet vendimi i Kushtetueses



17 Shtator 2026, 17:48, Aktualitet CNA



Bordi i Shoqatës Evropiane të Gjyqtarëve (EAJ) ka shprehur shqetësimin lidhur me zhvillimet në Shqipëri në lidhje me pagat e magjistratëve.

Sipas EAJ, Gjykata Kushtetuese, në vendimin e saj nr. 15/2026, e deklaroi sistemin ekzistues të pagave për gjyqtarët, prokurorët dhe personelin tjetër gjyqësor antikushtetues dhe urdhëroi ligjvënësin që të ndryshojë dispozitat përkatëse në përputhje me udhëzimet e saj brenda një afati të përcaktuar.

Bordi i Shoqatës Evropiane të Gjyqtarëve, në reagimin e tij thekson se, këto udhëzime u shpërfillën dhe u refuzua pagesa e shumës së përcaktuar nga gjykata

Po ashtu ka reaguar në lidhje dhe me projektligjin e miratuar në Komisionin e Ligjeve që pritet të votohet në parlament.

Bordi i Shoqatës Evropiane të Gjyqtarëve nënvizon se nëse ky projektligj do të miratohej, ai jo vetëm që do të shfuqizonte rregullimin që rezultoi drejtpërdrejt nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese, por gjithashtu do të vendoste në mënyrë prapavepruese një metodë llogaritjeje që duket po aq problematike sa ajo që gjykata e konstatoi antikushtetuese. Sipas Bordit të Shoqatës Evropiane të Gjyqtarëve ligjvënësi po përpqet të anashkalojë zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

Në reagim theksohet se mosrespektimi i një vendimi të Gjykatës Kushtetuese është i barasvlefshëm me shkeljen e vetë Kushtetutës.

“Shoqata Evropiane e Gjyqtarëve. Grupi Rajonal i Shoqatës Ndërkombëtare të Gjyqtarëve.

Bordi i Shoqatës Evropiane të Gjyqtarëve (EAJ) shpreh shqetësimin e tij të thellë lidhur me zhvillimet në Shqipëri. Gjykata Kushtetuese, në Vendimin e saj nr. 15/2026, e deklaroi sistemin ekzistues të pagave për gjyqtarët, prokurorët dhe personelin tjetër gjyqësor antikushtetues dhe urdhëroi ligjvënësin që të ndryshojë dispozitat përkatëse në përputhje me udhëzimet e saj brenda një afati të përcaktuar. Ajo gjithashtu përcakton se cilat dispozita do të zbatohen në rast se ligjvënësi nuk vepron. Jo vetëm që këto udhëzime u shpërfillën dhe u refuzua pagesa e shumë së përcaktuar nga gjykata, por në Parlament madje u paraqit një projektligj që parashikonte një rillogaritje me efekt prapaveprues të shpërblimit në fjalë.

Nëse ky projektligj do të miratohej, ai jo vetëm që do të shfuqizonte rregullimin që rezultoi drejtpërdrejt nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese, por gjithashtu do të vendoste në mënyrë prapavepruese një metodë llogaritjeje që duket po aq problematike sa ajo që gjykata e konstatoi antikushtetuese. Me pak fjalë, ligjvënësi po përpqet të anashkalojë zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

Zbatimi efektiv i vendimeve gjyqësore, i cili buron nga natyra e tyre detyruese, është një element themelor i shtetit të së drejtës. Vetë koncepti i një gjykate të pavarur, i përcaktuar në nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nënkupton që një gjykatë ka autoritetin për të dhënë një vendim detyrues, i cili nuk i nënshtrohet ndryshimit, miratimit ose ratifikimit nga ndonjë autoritet jogjyqësor.

Lidhur në mënyrë specifike me zbatimin e vendimeve të gjykatave kushtetuese, natyra e tyre përfundimtare dhe detyruese rrjedh domosdoshmërisht nga epërsia e Kushtetutës. Këto vendime duhet të respektohen nga të gjitha autoritetet publike dhe individët. Mosrespektimi i një vendimi të gjykatës kushtetuese është i barasvlefshëm me shkeljen e vetë Kushtetutës.

Nga ky këndvështrim, zhvillimet e përmendura më sipër shkelin shtetin e së drejtës, pavarësinë e gjyqësorit dhe ndarjen e pushteteve. Ato gjithashtu dëmtojnë besimin te shteti dhe reformat pozitive të sistemit gjyqësor në Shqipëri, të cilat janë arritur deri më tani përmes përpjekjeve të mëdha.

Bordi i EAJ-së, për këtë arsye, shpreson që ky regres i propozuar të mund të parandalohet. Ai do të mbështesë anëtarin e tij, Unionin e Gjyqtarëve të Shqipërisë, në përpjekjet e tij për ta arritur këtë qëllim, do ta vendosë çështjen në rendin e ditës së Asamblesë së Përgjithshme të tij — e cila do të zhvillohet në tetor në Lisbonë dhe do të informojë aktorët përkatës ndërkombëtarë dhe evropianë për situatën alarmante në Shqipëri”, thuhet në reagim./ CNA

Association Européenne des Magistrats
Groupe Régional de l'Union
Internationale des Magistrats



European Association of Judges
Regional Group of the
International Association of Judges

The Board of the European Association of Judges (EAJ) expresses its deep concern regarding the developments in Albania. The Constitutional Court in its Ruling 15/2026 declared the existing salary system for judges, prosecutors, and other court staff unconstitutional and ordered the legislature to amend the relevant provisions in accordance with its directives within a set timeframe. It also specifies which provisions are to apply in the event that the legislature fails to act. Not only were these instructions disregarded and payment of the amount set by the court refused, but a bill was even introduced in Parliament that provided for a retroactive recalculation of the remuneration in question.

If this bill were to be passed, it would not only repeal the regulation that resulted directly from the Constitutional Court's ruling, but would also retroactively introduce a calculation method that appears just as problematic as the one the court found to be unconstitutional. In short, the legislature is attempting to circumvent the implementation of the Constitutional Court's ruling.

The effective enforcement of court decisions, which stems from their binding nature, is


a fundamental element of the rule of law. The very concept of an independent tribunal set out in Article 6 of the European Convention on Human Rights implies that a tribunal has the authority to render a binding decision that is not subject to modification, approval, or ratification by any non-judicial authority.

With regard specifically to the enforcement of constitutional court rulings, their final and binding nature necessarily stems from the primacy of the Constitution. These rulings must be observed by all public authorities and individuals. Failure to comply with a constitutional court ruling is tantamount to a violation of the Constitution itself.


From this perspective, the developments mentioned above violate the rule of law, the independence of the judiciary, and the balance of powers. They also undermine confidence in the state and the positive reforms of the judicial system in Albania, which have been achieved thus far through great effort.

The Board of the EAJ therefore hopes that this proposed regression can be prevented. It will support its member, the Union of Judges of Albania, in its efforts to achieve this goal, place the issue on the agenda of its General Assembly—which will take place in October in Lisbon—and inform the relevant international and European stakeholders about the alarming situation in Albania.

The Board of the EAJ




Sabina Matejka
President of the EAJ



Roland Kempfle
Vice President



Dorota Zabłudowska
Vice President



Të sugjeruara

Audiopërgjimet e Ahmetajt/ Këlliçi zbardh aferën, si u morën 30 milionë euro nga taksat e

shqiptarëve

Deklarata e Kuvendit për vendimin e Hagës/ Këlliçi: Manovër për t'u hedhur hi në sy shqiptarëve

Situata në aeroportin e Vlorës/ Pacolli: Nuk synojmë zgjidhjen përmes Arbitrazhit

Berisha, takim me Dieter Althaus: Narkoshteti i Ramës, problem madhor i Shqipërisë

"Marketi katunit"/ Investimi më i ri i "Rozafës" në Fier

Vendimi i Hagës/ Kuvendi, kundër përpjekjeve serbo-ruse për të instrumentalizuar procesin

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.